

NJOFTIM / THIRRJE PËR REZIDENCË ARTISTIKE

Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit dhe Kinoteka e Malit të Zi shpallin një konkurs publik në kuadër të Programit Interreg IPA CBC Itali-Shqipëri-Mali i Zi RECON/Nr. 399/Thirrje e synuar për Propozime Projektsh “Rivlerësimi i Rrjetit të Trashëgimisë Kulturore, Dijes dhe Mundësive” për prodhimin gjatë residences artistike të një dokumentari me metrazh të shkurtër/mesëm (minimumi 15 minuta) dhe një video-instalacioni (pa limit kohor).

Dokumentari dhe video-instalacioni duhet të bëhen ekskluzivisht me materiale arkivore pjesë e koleksioneve filmike të Kinematekës Malazeze, që datojnë nga viti 1946 deri në 1989. Të drejtën e pjesëmarrjes në konkurs e kanë individë, regjisorë filmash dhe artistë bashkëkohorë shtetas të Shqipërisë. Kandidatët duhet të flasin rrjedhshëm gjuhën angleze. Aplikimi plotësohet në gjuhën angleze.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 11.05.2022, ora 14:00 me email: info@aqshf.gov.al.

Procedurën për përzgjedhjen e pjesëmarrësve në projekt, e kryen komisioni përzgjedhës i Kinematekës së Malit të Zi dhe Komunës së Termolit. Parapërzgjedhja e projekteve do të bëhet sipas kriterëve të mëposhtme: 35 pikë për veprat e mëparshme të artistit, 35 pikë për kreativitetin e projektit të propozuar, 20 pikë për trajtimin e autorit dhe 10 pikë për realizueshmërinë e projektit. Më pas do të zhvillohet një intervistë nëpërmjet një linku Zoom me kandidatët e përzgjedhur dhe do të merret një vendim brenda pesë ditëve, i cili do të publikohet në faqen e internetit të Arkivit Qendror Shtetëror të Filmit.

Përshkrimi i projektit:

- Artistët fitues do të marrin një grant i cili do të mbulojë qëndrimin e tyre në Podgoricë (rreth 45 ditë) në akomodim të zgjedhur nga ata vetë, dhe që përfshin kompensim për veprën e krijuar gjatë periudhës nga 1 qershori deri më 15 korrik 2022, në ambientet e Kinematekës malazeze. Regjisorin dhe artistin do të zgjedhin material filmik për t'u dixhitalizuar dhe më pas për të punuar me redaktorin dhe dizajnerin e zërit të caktuar për të krijuar veprën. Kësti i parë i grantit do të paguhet një javë para fillimit të projektit (60%), dhe kësti i fundit do të paguhet gjatë gushtit 2022.

- Dokumentari do të trajtohet si vepër e prodhuar nga Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit;
- Autorët nuk duhet të përdorin materiale të tjera përveç atyre në arkiv, gjë që përjashton mundësinë e xhirimeve shtesë (përveç regjistrimeve audio të zërit);
- Autorët mund të zgjedhin muzikën që gjendet në fondet arkivore dhe jashtë tyre, brenda buxhetit të caktuar për të drejtën e autorit;
- Instalacioni i videos nuk përfshin ndërhyrje në hapësirën e galerisë ku do të ekspozohet por vetëm projeksion në një ekran ose pajisje televizive.

Promovimi i video-instalacionit dhe dokumentarit që do të krijohen si pjesë e këtij projekti, do të prezantohen në Mal të Zi, Shqipëri dhe Itali.

Kandidatët e interesuar mund të shkruajnë në adresën e e-mail: milena.charan@kinoteka.me për të kërkuar çdo informacion shtesë.

APPLICATION FORM

Name and Surname of the candidate	
Residential address	
Email and phone number	
The field in which the competition is held (documentary film or contemporary art)	
Candidate's biography	
Filmography / list of exhibitions	
Links to previous works	

PROJECT PROPOSAL

Title of the work	
The theme of the work	
Detailed description of the idea for the video installation / treatment of the documentary	
Author's explication	

Additional notes regarding the project	
---	--

Date _____, 2022 in _____

Candidate's signature